

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	VIDEO -
ADRESA	https://www.syri.net/politike/919067/fonde-ipard-deti-i-be-se-nuk-u-be-kos-sharka-me-ket-e-qeveri-e-keto-skandale-s-do-kemi-me-financime/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 09:06:46 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 08:36:24 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	aa64558d357f4136bdbd9dd42e81d069335385dc88c22c2ad18976036fee7504
TEKSTI	2fcffe6dc52342165a5e3731cf7bd5d555462e29900e398a8426f4eee2a964c6
PAMJA	e8f8df8ab90eae543d1fa1d77b9b428cbf1be1b3a590643038a089435ecf02ce

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	3ea91e0caaa3630e6d2bc00d124425edbc7f04647171c9a135fddf503d48b5c0
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	8b8efb9319bb60e287a9053a50eed732645594d6e8c6608cdf651dfbc0b1533
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/3ea91e0caaa3630e6d2bc00d124425edbc7f04647171c9a135fddf503d48b5c0>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.


Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**NDRIÇIM KULLA**

Dorëheqja urgjente e Edi Ramës nuk është më vetëm një kërkesë e opozitës, edhe e ndërkombëtareve

**ENVER BYTYÇI**

Vendimi i Hagës dhe raporti ynë me të vërtetën!

**më të lexuarat**


'Iu hoq cipa e maskës mazhorancës', Goxhaj: Po i vjen fundi kësaj kaste, Rama s' menaxhon dot më



Mashtrimi me shëndetësinë falas: Shqipëria e dyta në Europë për koston e lartë



Akuzat ndaj shefes së SHISH vënë në pikëpyetje sigurinë kombëtare të Shqipërisë



'Qeveria braktisi qytetarët përballë çmimeve', aktivisti: Shqipëria mban TVSH-në 20% për shportën bazë



Akuzat për shefen e SHSH, Ndoja: Kjo është rënia e shtetit, është bashkuar me krimin



Fati i bashkëpunëtorëve kosovarë të Ramës



'Fonde IPARD? Deti i BE-së nuk u bë kos'/ Sharka: Me këtë qeveri e këto skandale, s'do kemi më financime

10:36, 25/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Premtime nga Tirana, por heshtje nga Brukseli dhe fermerët që vazhdojnë të presin. IPARD III, programi që duhet të sjellë miliona euro mbështetje europiane për bujqësinë shqiptare, ende nuk ka një datë zyrtare nisjeje.

Eduard Sharka, Drejtuesi i Departamentit të Bujqësisë në Partinë Demokratike në një intervistë për "Kafe Shqeto" është skeptik dhe nuk beson se BE do të shpërndajë fonde pa hetuar abuzimet.

"Unë besoj që deti i Bashkimit European nuk është bërë kos akoma që të rishpërndahen fonde të Bashkimit European pas gjetjeve të zyrës OLAF dhe po nuk u doli përgjegjësia dhe po nuk u kthyen fondet e IPARD II-shit që konsiderohen të shpërndara keq apo të abuzuara nga zyra OLAF.

Duhet ta dinë fermerët shqiptarë – unë besoj që qeveria e di, po nuk i intereson ta thotë – që gjetjet e zyrës OLAF janë bazuar në disa denoncime. Disa janë denoncime të qytetarëve shqiptarë, por ka dhe denoncime të furnitorëve europianë që furnizojnë me teknologji tregun. Dhe duhet të keni konsideratë që ata janë marrë në telefon nga Shqipëria dhe është thënë që "ne duam një makineri sepse po financohemi nga fondet IPARD, por ne duam t'u japim 5 lekë dhe faturën ta bëni prej 10 lekë.

Në moment që ato nuk kanë rënë dakord për këtë sepse janë kompani serioze, janë furnizuar diku tjetër këto dhe ata kanë njoftuar zyrën OLAF për këtë fenomen.

Pastaj kemi një nga gjetjet kryesore të zyrës OLAF është fatura e konsulencës të këtyre të disa zyrave që tregoheshin me gisht nga punonjës, nga drejtuesit e AZHBR-së dhe i thonë fermerëve se ajo zyrë e merr atë financimin.

Që kanë fatura me 20%, imagjinoni një një grant 500.000 euro dhe 20% i donte ajo zyra e konsulencës që të garantonte përfitimim e projektit tënd apo të fondeve IPARD. Dhe këto janë fakte shumë të vëra.

rendet që nuk i gjenim dot njëri tjetër.

Imagjinoni sikur këto të kenë shkruajtur që ne do fusim Shërbimin Secret Shqiptar që të jetë pjesë e monitorimit të shpërndarjes së fondit evropian për të shmangur abuzimet mbas skandalit që ndodhi. Edhe kjo kartë u ka rënë edhe kështu që unë besoj që drejtorja e zgjerimit që është duke u marrë me dosjen që ka çuar qeveria shqiptare edhe Komisioni Evropian duan prova të forta, prova të qëndrueshme që të riakreditojnë këto sisteme. Por unë besoj, edhe më vjen keq për këtë që e them, por sa të jetë kjo qeveri edhe këto drejtues institucionesh, dhe ky mekanizëm që çdo ditë diskreditohet edhe në sytë e Bashkimit Evropian, edhe në sytë e qytetarëve të gjithë botës – protesta, skandale të përditshme – ne nuk do kemi më financime. Fermerët nuk do kenë më financime nga Bashkimi Evropian sado deadline të vendosin ministrat, sado të mundohen të gjejnë një marrëveshje politike me Marta Kos, me funksionarë të tjerë atje.

Bashkimi Evropian ka akoma nëpunës publikë dhe funksionarë që respektojnë parimet dhe respektojnë taksat e qytetarëve të tyre dhe nuk kanë për të lejuar që të shkojnë në dorë të abuzuesve, siç janë sot drejtuesit

Imagjinoni ish-ministrin, ish-drejtoreshën e AZHBR-së që ka qenë në kohën që Bashkimi Evropian, zyra OLAF, ka gjetur këto shkelje që kërkon rikthimin e 33 milionë eurove, kryeministri e ka marrë këshilltare. Si duket i pëlqeu mënyra se si punonte, sepse nuk është pak të vjedhësh fondet e Bashkimit Evropian. Besoj që është kulmi i specializimit për të abuzuar me fondet publike. Imagjino buxhetin tonë çfarë i kanë bërë dhe çfarë i bëjnë këto mostra" tha Sharka për 'Kafe Shqeto'

© SYRI.net

Lexo edhe:



Gazeta amerikane: Ambasadori Wendt shkon në Shqipëri në kohën kur vendi është përfshirë nga protestat



Territorialja/ Intelektualët kundër shkrirjes së Bashkisë Patos, letër drejtuar Kuvendit



Vangeli: 'TIMAK Defence' fatura del para procedurës, kontrata më pas, thesari pagoi 8.6 mln lekë

Si kontrasti Guillaume/Hyseni shpjegon Shqipërinë 2026

Çmimet stratosferike në Shqipëri, Kedhi: Jemi në një krizë të madhe, ekonomike, sociale e demografike

Në gjithë Kosovën sot protestohet kundër vendimit ndaj ish-krerëve të UÇK-së

TË NGJASHME



Në gjithë Kosovën sot protestohet kundër vendimit ndaj ish-krerëve të UÇK-së



'Iu hoq cipa e maskës mazhorancës', Goxhaj: Po i vjen fundi kësaj kaste, Rama s'menaxhon dot më



Skandali i SHISH/ Alizoti: Rama është errësira, menaxheri, truri që mbledh pisllekun që ka pushtuar shtetin



'4.9 milionë euro për një shkollë me 5 klasa më pak', Xhixho: Arsimi falas vetëm në letër



Mediu: Ka rënë piramida e sigurisë kombëtare! Rrezikohen marrëdhëniet me SHBA e vendet e NATO-s



'Mazhoranca i ka bërë bllok drejtësisë', Dedaj: Rama duhet të mbajë përgjegjësi politike



VIDEO - Qytetari në SHBA debaton me Ballën dhe Bushatin: Si nuk keni turp - Futen me vrap në hotel

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MJEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku



tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur të faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.